

L I G J
Nr. 8902, datë 23.5.2002

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE SELISË SË SHENJTË PËR RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE TË
NDËRSJELLA”**

Në mbështetje të neneve 10 pika 5, 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:**

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3371, datë 14.6.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

MARRËVESHJE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SELISË SË SHENJTË
PËR RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE RECIPROKE

Republika e Shqipërisë dhe Selia e Shenjtë, duke pasur dëshirën e përbashkët për të forcuar dhe zhvilluar, në frymën e miqësisë, marrëdhëniet ekzistuese midis tyre,
dhe me qëllimin për të rregulluar përmes një marrëveshjeje të përbashkët statusin juridik të Kishës Katolike në Shqipëri,
bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Republika e Shqipërisë garanton lirinë për të shpallur dhe praktikuar në publik Fenë Katolike. Kisha Katolike në Shqipëri ka të drejtë të organizohet dhe të plotësojë misionin e saj.

Neni 2

Republika e Shqipërisë njeh zotësinë juridike të personave ligjorë për entitete të tilla të Kishës Katolike, të cilat janë të parashikuara në të Drejtën Kanonike, si arqidioqezat, dioqezat apo administraturat apostolike famullitë, bashkësitë fetare, misionet, shoqatat, seminarët, shkollat dhe institucionet arsimore të të gjitha niveleve, institucionet shëndetësore, pas regjistrimit të tyre nga organet e drejtësisë.

Neni 3

Selia e Shenjtë dhe Kisha Katolike në Shqipëri gëzojnë lirinë e plotë të komunikimit dhe të korrespondencës me njëra-tjetrën.

Republika e Shqipërisë dhe Selia e Shenjtë do të mbajnë marrëdhënie diplomatike në nivelin e Ambasadës dhe Nunciaturës Apostolike.

Neni 4

Kisha Katolike ka të drejtën të posedojë mjete të veta të komunikimit masiv dhe ka të drejtën të përdorë mjetet publike të komunikimit masiv, në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 5

Autoriteti kompetent kishtar ka të drejtë të krijojë strukturat përkatëse të Kishës, e në veçanti, të krijojë dhe të modifikojë personat juridikë kishtarë, në përputhje me të Drejtën Kanonike dhe duke respektuar ligjet shqiptare.

Selia e Shenjtë është e lirë të zgjedhë një klerik në detyrën e Ipeshkvit ose të Administratorit Apostolik, i cili mund të jetë dhe Ipeshkëv.

Përpara se të publikojë emërimin e Ipeshkvit apo të Administratorit Apostolik, Selia e Shenjtë, për mirësjellje dhe në konfidencë, do të informojë Presidentin e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Neni 6

Për të plotësuar përgjegjësitë që rrjedhin nga funksioni baritor, Ipeshkvi ose Administratori Apostolik ka të drejtë të ftojë në Shqipëri priftërinj, anëtarë të kongregacioneve rregulltare dhe persona laikë, të cilët nuk kanë nënshtetësinë shqiptare dhe të rekomandojë kërkesën e tyre për leje për rezidencë dhe për leje për punë drejtuar autoriteteve shqiptare, në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

Me kërkesën formale të Ipeshkvit ose të Administratorit Apostolik, leja për rezidencë dhe leja për punë, e nënkuptuar kjo për ushtrimin e aktivitetit baritor, do të lëshohen kundrejt një pagese minimale sipas legjislacionit dhe rregullave shqiptare.

Neni 7

Kisha Katolike ka të drejtë të hapë dhe të drejtojë shkollat, klinikat dhe qendrat sociale të saj sipas të Drejtës Kanonike dhe në përputhje me ligjet përkatëse të Republikës së Shqipërisë.

Neni 8

Republika e Shqipërisë do të kthejë pronat e Kishës Katolike, në përputhje me legjislacionin shqiptar, dhe do të asistojë reregjistrimin e tyre në emrin e Kishës Katolike në zyrat kompetente shtetërore.

Neni 9

Në rastet e çështjeve të dyshimta, të pazgjidhura dhe të diskutueshme, të cilat kanë të bëjnë me Kishën Katolike në Shqipëri në përgjithësi ose me komunitetet apo institucionet katolike në veçanti, Kisha Katolike në Shqipëri dhe autoriteti kompetent në Republikën e Shqipërisë do të krijojnë një komision “ad hoc” të përbashkët me detyrën për të gjetur zgjidhje të pranueshme nga të dyja Palët.

Neni 10

Nëse në të ardhmen do të lindin vështirësi në lidhje me dispozitat e mësipërme, që do të kenë të bëjnë me interpretimin apo aplikimin e tyre, Republika e Shqipërisë dhe Selia e Shenjtë do të procedojnë një marrëveshje të përbashkët për një zgjidhje miqësore.

Neni 11

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në momentin e njoftimit reciprok për plotësin nga Palët të procedurave të tyre të brendshme të kërkuara për hyrjen e saj në fuqi.

Kjo Marrëveshje mund të zgjidhet prej secilës nga Palët që do të njoftojë Palën tjetër për vendimin e saj me shkrim. Marrëveshja do të pushojë së ekzistuari nëntëdhjetë (90) ditë pas ditës së njoftimit.

Për Republikën e Shqipërisë

Për Selinë e Shenjtë